



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 93/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër menaxheres së Qendrës së Votimit (QV) Ganimete Konjufca, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.04.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datë 29.04.2012, prej orës 07:00 të hapjes së vendvotimit në Qendrën e Votimit 2501d/05R, në pozitën e komisionarit, si zyrtar identifikimi ka kryer këtë detyrë një person i paautorizuar me autorizim të menaxheres së kësaj Qendre të Votimit, Ganimete Konjufca, ka ushtruar detyrën e zyrtarit të identifikimit, deri në orën 20:00. Sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelja e nenit 2 paragrafi 2 i Rregullës Zgjedhore 09/2009.

**Neni 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), përcakton se:**

*PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

**Neni 118.4** *Mund të apelohej vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar.*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Nga shkresat e lëndës PZAP-i konstatoi, se ankesa është e pabazuar, për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ngase parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë apo dëshmi që do ti mbështeste apo do ti argumentonte, pretendimet ankimore, andaj në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

A nr. 93/2012 më datën 30.04.2012.

